



V E N D I M
K.P.P. 728/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatoriëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74140-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë - Velipojë, U.Bunës (E re)-Shirokë, Krye Bushat-B.Jugë, Rranxa-Kukël, K.Balldre-Porta e Aviacionit 71.4 km*”, me fond limit 55.559.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatoriëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatoriëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:	Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. Rruga “Bulevardi Skenderbeg”, pas Kinema Millenium, Shkodër Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. Shkodër, Postribë Mes, Rruga Nacionale Mes-Shkodër, godinë 1 katëshe, nr.pasurie 1/1, Zona Kadastrale 1545, Shkodër Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. Rruga “Imer Puka”, Blloku Nr. 03, Banesa Nr. 40, Kati I-rë, Pasuria Nr.1150, Z.K3069, Pukë Lagja “Gjakez”, Ndërtesa me Nr. Pasurie 40, Z.K 1717, Mirditë
Autoriteti Kontraktor:	Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër Lagja “3 Heronjtë”, Rruga “At Zef Valentini”, Shkodër
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “<i>Për Prokurimin Publik</i>”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “<i>Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”</i>”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k., ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel vetëm objektet e ankesave të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.06.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74140-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë - Velipojë, U.Bunës (E re)-Shirokë, Krye Bushat-B.Jugë, Rranxa-Kukël, K.Balldre-Porta e Aviacionit 71.4 km*”, me fond limit 55.559.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2. Në datën 10.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.08.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. 47.714.049 lekë, Skualifikuar
2. BOE “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.
48.337.336 lekë, Skualifikuar
3. “Jubica” sh.p.k. 49.330.000 lekë, Kualifikuar

- | | |
|---|-------------------------------|
| 4. BOE "Nika" sh.p.k. & "Rroku Guest" sh.p.k. | 50.956.451 lekë, Skualifikuar |
| 5. "S.M.O. Union" sh.p.k. | 52.383.292 lekë, Kualifikuar |

II.4. Në datën 07.08.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Nika" sh.p.k. & "Rroku Guest" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

"Nuk plotsoni kriteret per kualifikim. Kontrata me Alba-beton 07 dt 22.10.2015 -22.10.2018 per Kamion targe AA 648 Hb, Autobetonjere targe Sh 7982 E, Eskavator fiat hITACHI 157 kv, fadrome fiat hITACHI ë 130. Kjo Kontrate nuk ka objektin e prokurimit, dhe nuk perputhet me kerkesat e DST. Kontrat ne Nr 167 Rep, Nr 63 Kol. Dt 09 01.2018 me shoqerine "PAKO" per asfaltoshtreuse, theksojme se kjo Firme ka falimentuar dhe nuk ekziston. Kontrata Nr 8289 Rep, Nr 4283 Kol, me Firmen "Malesia Venture" per furnizim me asfaltobeton nuk perputhet me kerkesat e DST mbasi nuk eshte lidhur per objektin qe prokurohet, afati i saj eshte 22.10.2015-22.10.2018. Mjeti me targe SH 6271 E i paraqitur si bore pastruese nuk eshte APV, por kamion, po ashtu edhe mjeti targe AA 645 HB megjithse eshte kamion nuk eshte paraqitur ne foto sipas kerkesave te DST.

II.4.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Nika" sh.p.k. & "Rroku Guest" sh.p.k. në datën 10.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]Me kete vendimarrje nuk jemi dakort pasi eshte marre ne kundershtim me rrethanat e faktit dhe me parashikimet ligjore, prandaj kundershtojme si me poshte vijon:

Se pari, ne lidhje me pretendimin se kontrata me shoqerise ALBA BETON 07 eshte pa objekt prokurimi, sqarojme se kjo kontrate eshte perpiluar ne perputhje te plote me ligjin per Noterine dhe perman objekt te caktuar qe jane mjetet perkatese te marrura me qera dhe afat te caktuar qe eshte deri me date 22.10.2018. Po ashtu ne kete kontrate eshte e percaktuar se palet kane te drejte perseritje me te njejtat kushte pas perfundimit te kesaj kontrate. E duke qene se ne nje moment ne mund te jemi eventualisht fitues dhe ne perputhje te plote me detyrimet e nje kontrate sipermarrje, sigurisht qe ky fakt do kishte perbere nje arse te plote per te vazhduar kontraten e qersase per kete mjete. E rendesishme ne kuptim te ligjit eshte fakti se ne i disponojme keto mjete ne momentin e vleresimit te ofertave dhe kjo eshte ajo qe parashikon ligji dhe cfare duhet te merret parasysh.

Se dyti, ne lidhje me pretendimin se afati i kontrates me shoqerine Malesia Valtur eshte deri me date 22.10.2018, sqarojme se kjo eshte thjeshte tendence per skualifikim dhe jo arsye ligjore e cila eventualisht mund te coje ne mos realizimin e sherbimit te prokuruar. Nga ana jone momentalisht jane te kontraktuara te gjitha mjetet dhe makinerite e kerkuara ne kete procedure prokurimi. Ato jane te shoqeruara me te gjitha dokumentacionin e nevojshem tekniko-ligjor. Nese ne do shpallemi eventualisht fitues, rrjedhimisht i bie qe edhe te jemi kontraktor te ardhshem. Dhe duke qene se kontrata perman detyrime reciproke, ne jo vetem qe do angazhohemi per te kryer sherbimin ne menyren e duhur dhe sipas specifikimeve teknike, por nga ana tjeter do kemi edhe angazhimin maksimal per te garantuar disponibilitetin e te gjitha mjeteve te nevojshme. Te gjitha kontratat e qerases qe kemi, percaktojne faktin se pas perfundimit te afatit te qerases, palet kane te drejte te perserisin kontraten me te njejtat kushte te vecanta. Ne keto kushte, duke pasur aktualisht gjendjen ne formen juridike dhe fizike te te gjitha mjeteve dhe makinerive te kerkuara ne kete procedure prokurimi, duke pasur njekohesisht edhe detyrime eventuale ne baze te kontrates qe mund te lidhet

me institucionin tuaj si dhe duke pasur te gjitha te drejtat ligjore per te vazhduar kontraten e qerase. Ne sigurisht qe do e bejme nje gje te tille dhe garantojme realizimin e sherbimeve te prokuruaras sipas projekt-preventivit dhe specifikimeve teknike.

Se treti, ne lidhje me faktin se pretendohet se kjo kontrate me firmen Pako nuk eshte e rregullt pasi kjo firme ka falimentuar. Sqarojme se kjo nuk eshte e vertete, firma Pako eshte momentalisht e pezulluar dhe jo e falimentuar, por kjo gje nuk e pengon te jap me qera mjetet qe ajo disponon.

Se katerti, ne lidhje me pretendimin se Borepastrueset nuk jane te rregullta sqarojme se ato jane plotesisht te rregullta dhe te gatshme per te kryer sherbimin ne cdo moment. Borepastruese jane te pajisura me te gjith aksessore perkates dhe te shoqeruara me foto.

Po ashtu sqarojme se vleresimi eshte bere selektiv pasi operatoret e kualifikuar dhe eventualisht fitues, me te njejta kriteret dhe me te njejtin dokumentacion jane skualifikuar ne procedura te ngjashme te zhvilluara nga Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane ku edhe ne kemi qene pjesemarres. Prandaj kërkojmë që të verifikohet edhe fakti se a i plotesojne kriteret e DST edhe operatoret e tjere te kualifikuar dhe a është ndjekur e njeja logjike ligjore per vleresimin e ofertave te operatoreve ekonomik pjesemarres. Te ndodhur ne keto kushte ne sqarojme se me kete kuotim jo vetem qe po behet nje padrejtesi e hapur ndaj subjektit tone. Sa me siper kerkojme nga ana juaj te rishikohet vendimi i komisionit te vleresimit te ofertave, te kualifikohet dhe te shpallet fituese shoqeria Nika sh.p.k.

II.4.2. Në datën 17.08.2018, me anë të shkresës nr. 345 prot., datë 17.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor, për refuzimin e ankesës së tij, në datën 18.08.2018.

II.4.3. Në datën 27.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 07.08.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Nuk plotesoni kerkesat e kualifikimit. Mjeti targe SH 8762 E megjithese sipas Lejes se Qarkullimit eshte APV sipas fotos se paraqitur nuk plotesoni kerkesat sipas DST, kapaciteti teknik. Mjeti targe 04-210-FI nuk keni kontrate noteriale, nuk ka vule apostile si dhe lejen e qarkullimit, nuk eshte mjet per pastrim bore por kamion. Mungon certifikata ISO 3901 2012 Shoqerise "Karl Gega Konstruksion".

II.5.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. në datën 10.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.2. Në datën 17.08.2018, me anë të shkresës nr.345/1 prot., datë 17.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB –

Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor, për refuzimin e ankesës së tij, në datën 24.08.2018.

II.5.3. Në datën 28.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 07.08.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“- Nuk plotesoni kushtet per kualifikim Mjeti me Targe AA 718 GU nuk eshte APV sipas kerkesave te DST, megjithese ne foto duket borepastruese.

- Drini 1 mungojne raportet e Auditimit te Bilancit nga eksperti kontabel.

- Mjeti targe AA 402 GY nuk eshte sipas kerkesave te DST eshte nen 1 ton.

- Preventivi nuk eshte plotsuar teresisht Preventivi Nr 2 nuk eshte plotsuar oferta formulari nr 8, gjithashtu edhe Preventivi nr 3 nuk eshte plotsuar oferte per formularin nr 8.”

II.6.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. në datën 14.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në ankesën e tij pretendon:

[...] Për sa i përket çështjes së parë ku bilancet e viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini-1” sh.p.k. nuk janë të shoqëruar nga raporti i auditimit mendojmë se kjo nuk qëndron për këto arsye:

a.Ne VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar [...] Neni 26 Pika 7 “Per te provuar permbushjen e kriterit per kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kerkon: kopje te certifikuara te nje ose me shume balanceve, te paraqitura ne autoritetet perkatese”. Neni 46 i LPP-se, germa "c" gjendja ekonomike e financiare: operoret ekonomike vertetojne se zoterojne kapacitetet ekonomike e financiare per te permbushur kontraten, me ane te deklarave bankare ose, kur nevojitet, nepermjet vertetimit per sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes se balanceve financiare ose te pjeseve te shkeputura nga bilancet, nje deklarate te xhiros se pergjithshme te shoqerise dhe, ne rast nevojë, te xhiros se realizuar nga veprimtarite e ngjashme me objektin e kontrates qe do te prokurohet per nje periudhe deri ne 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion eshte i mundur, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone, pasi bilancet e dorezuara jane te certifikuara nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder. Bilanci nuk mund te certifikohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder nese nuk eshte kryer raporti i auditimit të pavarur. Mos paraqitja e raportit nga ana jone ka qene nje gabim teknik, por qe nuk përbën kusht për të refuzuar ofertën dhe në nenin e sipërpërmendur nuk citohen raporte e auditimit kerkohen vetem pasqyrat financiare ose pjese te shkeputare te sajë.

b. Persa i perket ceshtjes ku thuhet se mjeti me targe AA718GU nuk eshte APV sipas DST me gjithse ne foto duket borpastruese, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone pavarsisht se ne lejen e qarkullimit te mjetit nuk thuhet apv nuk mendoj se perben kush per skualifikim pasi KVO ka te

drejten te beje dhe verifikimet e saj nese ky mjet eshte apo jo borpastruese, ky mjet ka sherbyer si borepastruese ne rugen e Kombit dhe disponojme zhdoganimet e kazanit te kripes dhe te thikes qe pastron boren.

c.Persa i perket ceshtjes se trete ku thuhet mjeti me targe AA402GY eshte nen 1 ton dhe nuk eshte plotesuar sipas DST, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone pasi ne lejen e qarkullimit te mjetit ne piken 23 dhe 24 te saj e cila ben fjale per peshen bosh dhe maksimale te saj (pesha bosh eshte 1915 Kg dhe pesha maksimale eshte 2800 Kg) pasi ne DST eshte kerkuar (Kamioncin mbi 1 ton) kriter i plotesuar nga ana jone.

d. Persa i perket ceshtjes se kater ku thuhet se preventive nuk eshte plotesuar teresisht Preventivi Nr 2 nuk eshte plotesuar nuk eshte plotesuar oferta formulari nr 8, gjithashtu dhe Preventivi Nr 3 nuk eshte plotesuar oferta per formularin nr 8, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone, pasi vlera e dites se punes (3% e vleres se preventivit nr 2) eshte plotesuar te tabela permbledhese e preventivit nr 2 dhe nr 3 si dhe ne listat nr 8 per secilen. Detajimet i metejsheem nuk eshte kryer nga ana juaj (sasi). Shumat e preventivave perkates jane te sakte dhe te plotesuar ne formularin perkates sipas DST-se.

Ne mbeshteje te argumentave te mesiperm kemi dhe sa me poshte: Ne LPP Nr. 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, neni 53 pika 4 (cituar) [...], neni 55, pika a (cituar) [...]. Në mbështetje të nenit 55 të LPP, i ndryshuar, oferta jonë është 1,615,951 lekë më pak se oferta e shpallur fituese nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Në këto kushte refuzimi i ofertës tonë është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj. Prandaj në mbështetje të nenit 78 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, kërkojmë pranimin e kërkesës dhe rivlerësimin e ofertës tonë. Ne rast të kundërt kemi dyshime se autoriteti kontraktor është në kushtet e nenit 26 të LPP, i ndryshuar. Në raste mosrivlerësimi të ofertës tonë bazuar në nenin 63 pika 6, të LPP do ti drejtohem organeve kompetente.

II.6.2. Në datën 20.08.2018, me anë të shkresës nr.347 prot., datë 20.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij.

II.6.3. Në datën 29.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 372 prot., datë 10.09.2018, protokolluar me tonën në datën 12.08.2018 dhe shkresës nr. 374 prot., datë 10.09.2018, protokolluar me tonën në datën 12.08.2018, me objekt “Kthim përgjigje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomikë në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.08.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht si më poshtë vijon:

1. BOE “Drini - 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. 47.714.049 lekë, Skualifikuar
2. BOE “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruktion” sh.p.k. 48.337.336 lekë, Skualifikuar
3. “Jubica” sh.p.k. 49.330.000 lekë, Kualifikuar
4. BOE “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. 50.956.451 lekë, Skualifikuar
5. “S.M.O. Union” sh.p.k. 52.383.292 lekë, Kualifikuar

III.1.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. në datën 10.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.3. Në datën 17.08.2018, me anë të shkresës nr.345 prot., datë 17.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor, për refuzimin e ankesës së tij, në datën 18.08.2018.

III.1.4. Në datën 27.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.5. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP-së. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i

pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.7. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP, nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k., konstaton se ky i fundit, ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke ngritur pretendime, vetëm mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë që, referuar klasifikimit të ofertave të datës 07.08.2018 në SPE, rezulton se, operatori ekonomik “Jubica” sh.p.k. është i kualifikuar dhe i renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën pranë KPP ka ngritur pretendime vetëm mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike dhe në asnjë rast nuk ka kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., i cili rezulton i kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike.

III.1.9. Në lidhje me pretendimin e ngritur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues për operatorët e kualifikuar në këtë procedurë prokurimi (citojmë) *“Po ashtu sqarojme se vleresimi eshte bere selektiv pasi operatoret e kualifikuar dhe eventualisht fitues, me te njejta kriteret dhe me te njejtin dokumentacion jane skualifikuar ne procedura te ngjashme te zhvilluara nga Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane ku edhe ne kemi qene pjesemarres. Prandaj kërkojmë që të verifikohet edhe fakti se a i plotesojne kriteret e DST edhe operatoret e tjere te kualifikuar dhe a është ndjekur e njeja logjike ligjore per vleresimin e ofertave te operatorëve ekonomik pjesmarres”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë kriteret në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotësojnë kriteret e vendosura në DST operatorët e kualifikuar.

III.1.9.1. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe *“elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”*, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.1.9.2. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.9.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kriteresh.

III.1.9.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.9.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.1.9.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.9.7. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij të dhëna nga autoriteti kontraktor nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimes. Në lidhje me afatet, pas shqyrtimit, rezulton si më poshtë:

III.2.1. Në datën 11.06.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74140-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë - Velipojë, U.Bunës (E re)-Shirokë, Krye Bushat-B.Jugë, Rranxa-Kukël, K.Balldre-Porta e Aviacionit 71.4 km*”, me fond limit 55.559.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

III.2.2. Në datën 10.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.2.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 07.08.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me këtë klasifikim.

III.2.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. në datën 10.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.5. Në datën 17.08.2018, me anë të shkresës nr.345/1 prot., datë 17.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij.

III.2.6. Në datën 28.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Në ankesën drejtuar pranë KPP, ky i fundit ka paraqitur zarfin me anë të të cilit është dërguar shkresa kthim përgjigje e ankesës, nga autoriteti kontraktor tek bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, ku vula postare në këtë zarf mban datën 24.08.2018.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, ku është parashikuar: “*Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” “*Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji*”. “*Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës*”.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “*Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor*”.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, konstatohet se, ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 10.08.2018. Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se, ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim *brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor*. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Mosrespektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimues, pasi, kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së. Sa më sipër, KPP konstaton se, ankimi i dorëzuar pranë KPP-së nga operatori ekonomik ankimues më datë 28.08.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur operatori ekonomik ankimues duhet të ishte njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës nga ky i fundit, dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues është tejkaluar dhe është paraqitur prej këtij të fundit pas përfundimit të afatit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë KPP-së.

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB – Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. pranë KPP- së, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2.10. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga bashkimi i

operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k., për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se: *“Persa i perket ceshtjes ku thuhet se mjeti me targe AA718GU nuk eshte APV sipas DST me gjithse ne foto duket borpastruese, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone pavarisht se ne lejen e qarkullimit te mjetit nuk thuhet apv nuk mendoj se perben kush per skualifikim pasi KVO ka te drejten te beje dhe verifikimet e saj nese ky mjet eshte apo jo borpastruese, ky mjet ka sherbyer si borepastruese ne rugen e Kombit dhe disponojme zhdoganimet e kazanit te kripes dhe te thikes qe pastron boren”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe makinerite qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Mjet per vendosje parrakesh metalik (guardrails)i Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontrate furnizimi per asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh per menaxhim trafiku	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë në pronesi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri), çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike, kur janë në pronesi duhet të paraqitet kontrata e blerjes, c'doganimi në Shqipëri ose (kalimi në regjim të perkohshme) dhe faturat tatimore perkatese.
- c) Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, (të deklarohet nga qiradhenesi që mjeti nuk i është dhënë me qira ndonjë subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalet si dhe afati i saj dhe të mos jënë të nënshkruara përpara janarit të vitit 2018.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Për sa ju përket mjetve borepastruese duhet të jënë të paisura me kripore dhe thike (ku të komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo të jënë të improvizuara si mjete borepastruese duke bërë bashkim pjesesh për të improvizuar borepastruese).
- g) Për mjetet borepastruese në lejet e qarkullimit të tyre duhet të jete e cilesuar si APV (automjet i përdorimit të vecantë).
- h) Mjetet borepastruese duhet të shoqerohen minimalisht me nga dy foto ku të dallohen qartësisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

III.3.2. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.7 autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

Pika 2.3.7 germa "c" tek kriteret e vecanta për kualifikim "Kapaciteti teknik", ishte kerkuar ;

Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, (të deklarohet nga qiradhenesi që mjeti nuk i është dhënë me qira ndonjë subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalet si dhe afati i saj dhe të mos jënë të nënshkruara përpara janarit të vitit 2018.

Pika 2.3.7 germa "c" tek kriteret e vecanta për kualifikim "Kapaciteti teknik" ndryshon si më poshtë;

Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatese të

qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Drini – 1” sh.p.k., shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k., nga ku shoqëria “Drini – 1” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 51% të vlerës së përgjithshme të punimeve, dhe shoqëria “AEK Munella” merr përsipër të kryejë 49% të vlerës së përgjithshme të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “AEK Munella” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k. mbi disponimin e makinerive.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Drini-1” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruar sipas shtojcës 9, do të vihen në dispozicion të objektit të siperpermendur dhe nuk do të jenë të angazhuara në ndonjë objekt tjetër.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “AEK Munella” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruar sipas shtojcës 9, do të vihen në dispozicion të objektit të siperpermendur dhe nuk do të jenë të angazhuara në ndonjë objekt tjetër.
- Certifikatën e pronësisë së mjetit me targë AA718GU, në emër të shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k. shoqëruar me Lejen e Qarkullimit, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Siguracionin e mjetit dhe foto të mjetit.
- Lejen e qarkullimit të mjetit me targë PU 1561 A, në emër të shoqërisë “Drini-1” sh.p.k. shoqëruar me, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Siguracionin e mjetit dhe foto të mjetit

III.3.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.3.6. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]*”

III.3.7. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*”

III.3.8. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.3.9. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 54, pika 1/g, parashikohet:

“*g) Automjetet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.*”

Ndërsa në pikën 2 të po këtij neni parashikohet: “*Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.*”

III.3.10. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 201 “Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)”, pika 2, parashikohet:

2. Klasifikohen, në baze të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme:

a) traktori rrugor;

b) autopastruesja;

c) autopompa;

ç) autopastruesja e bores;

d) autoujitesja;

dh) autooficina;

e) automjetet e shkalles dhe automjetet për riparimin e linjave elektrike;

ë) automjetet me vinç gru;

f) automjetet për ndihmen e shpejte në rruge;

g) automjetet me pedane apo kosh të ngritshem;
 gj) autobluajtesja shkoqese;
 h) autofshiresja;
 i) autoambulanca;
 j) automjetet e varrimit;
 k) autofurgonet e blinduar, për transportin e të burgosurve;
 l) automjetet për dezinfektim;
 m) autoreklamata dhe mjetet për ekspozime reklamash, të pajisura me karrocieri të veçantë për këtë funksion, që nuk lejon përdorime të tjera dhe ku sendet që transportohen nuk hiqen kurrë nga mjeti;
 n) automjetet për radio, televizion, kinema;
 o) automjetet e caktuara për shfaqje në levizje;
 p) automjetet e pajisura me ambulanca të levizshme;
 q) autotendat;
 r) automjetet e pajisura për sperkatje të fushave;
 rr) autosaldatricja;
 s) automjet me aparatura telegrafike;
 sh) autogermuesja;
 t) autoshpuesja;
 th) autosharra;
 u) automjetet e pajisura me gjenerator;
 v) autopompa për beton;
 z) automjetet e tjera të pajisura me vegla të njohura nga Ministria e Transportit, të përshtatshme për përdorim të veçantë.

III.3.11. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.12. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.3.13. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit duhet të kenë në pronësi ose me qira 2 (dy) borëpastruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu në dokumentat e tenderit është kërkuar shprehimisht, që mjeti borëpastruese në lejen e qarkullimit duhet të jetë e cilësuar si APV (automjet i përdorimit të veçantë). Në rastin konkret nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Drini – 1" sh.p.k. & "AEK Munella" sh.p.k. konstatohet se ky i fundit në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, ku në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi ka paraqitur nga një

mjet borëpastrues, konkretisht operatori ekonomik ”Drini – 1” sh.p.k. ka paraqitur mjetin me targë me targë PU1561A dhe operatori ekonomik “AEK Munella” sh.p.k. ka paraqitur mjetin me targë AA718GU.

Sa më sipër, referuar arsyes së skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga autoritetit kontraktor, konkretisht ”Mjeti me Targe AA 718 GU nuk eshte APV sipas kerkesave te DST”, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për këtë mjet, konstaton se, në lejen e qarkullimit, tek ”Të dhëna mbi identifikimin e mjetit”, pika 1, ”Lloji i mjetit”, përcaktohet lloji ”Kamion”, ndërkohë që, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, është kërkuar shprehimisht që për mjetin borëpastruese në lejen e qarkullimit të tij duhet të përcaktohet lloji ”APV” (automjet për përdorim të veçantë). Akoma më tej, referuar legjislacionit përkatës të kësaj fushe, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, dhe akteve në zbatim të tij, VKM-së Nr.153 datë 07.04.2000 ”Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, është përcaktuar që borëpastruesja klasifikohet si ”Automjet për përdorim të veçantë” pra ”APV”, kështu që rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me dy borëpastruese, pasi borëpastruesja me targë AA718GU e paraqitur nga ky bashkim, në lejen e qarkullimit, rezulton ”Kamion” dhe jo ”APV”. Gjithashtu, edhe në të gjithë dokumentacionin tjetër shoqërues për këtë mjet, si certifikata e pronësisë së mjetit dhe certifikata e kontrollit teknik, ky mjet është cilësuar ”Kamion”.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ”Drini - 1” sh.p.k. & ”AEK Munella” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nuk qëndron, pasi ky i fundit nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me borëpastrueset.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ”Drini – 1” sh.p.k. & ”AEK Munella” sh.p.k., për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se: *”Persa i perket ceshtjes se trete ku thuhet mjeti me targe AA402GY eshte nen 1 ton dhe nuk eshte plotesuar sipas DST, kriter i cili eshte plotesuar nga ana jone pasi ne lejen e qarkullimit te mjetit ne piken 23 dhe 24 te saj e cila ben fjale per peshen bosh dhe maksimale te saj (pesha boshe eshte 1915 Kg dhe pesha maksimale eshte 2800 Kg) pasi ne DST eshte kerkuar (Kamioncin mbi 1 ton) kriter i plotesuar nga ana jone”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 *”Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 2.3.7 e *”Kapacitetit teknik”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe makinerite qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1

4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Mjet per vendosje parrakesh metalik (guardrails)i Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontrate furnizimi per asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh per menaxhim trafiku	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

- i) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).
- j) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike, kur janë në pronësi duhet të paraqitet kontrata e blerjes, c'doganimi në Shqipëri ose (kalimi në regjim të perkohshme) dhe faturat tatimore përkatëse.
- k) Për mjetet e siguruar me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, (të deklarohet nga qiradhenesi që mjeti nuk i është dhënë me qira ndonjë subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalet si dhe afati i saj dhe të mos jepen të nënshkruara përpara janarit të vitit 2018.
- l) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- m) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- n) Për sa ju përket mjetve borepastruese duhet të jepen të paisura me kripore dhe thike (ku të komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo të jepen të improvizuara si mjete borepastruese duke bërë bashkim pjesësh për të improvizuar borepastruese).
- o) Për mjetet borepastruese në lejet e qarkullimit të tyre duhet të jepen të cilësuar si APV (automjet i përdorimit të vecantë).
- p) Mjetet borepastruese duhet të shoqërohen minimalisht me nga dy foto ku të dallohen qartësisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

III.4.2. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.7 autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

*Pika 2.3.7 germa “c” tek kriteret e vecanta per kualifikim “Kapaciteti teknik”, ishte kerkuar ;
Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj dhe te mos jene te nenshkruara perpara janarit te vitit 2018.
Pika 2.3.7 germa “c” tek kriteret e vecanta per kualifikim “Kapaciteti teknik” ndryshon si me poshte;*

Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Drini – 1” sh.p.k., shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k., nga ku shoqëria “Drini – 1” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 51% të vlerës së përgjithshme të punimeve, dhe shoqëria “AEK Munella” merr përsipër të kryejë 49% të vlerës së përgjithshme të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “AEK Munella” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.4.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k. mbi disponimin e makinerive.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Drini-1” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruara sipas shtojcës 9, do të vihen në dispozicion të objektit të siperpermendur dhe nuk do të jenë të angazhuara në ndonjë objekt tjetër.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “AEK Munella” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruara sipas shtojcës 9, do të vihen në dispozicion të objektit të siperpermendur dhe nuk do të jenë të angazhuara në ndonjë objekt tjetër.
- Certifikaten e pronësisë së mjetit me targë AA935RT, në emër të shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k. shoqëruar me Lejen e Qarkullimit, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Siguracionin e mjetit dhe foto të mjetit.
- Lejen e qarkullimit të mjetit me targë AA402GY, në emër të shoqërisë “Drini-1” sh.p.k. shoqëruar me, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Siguracionin e mjetit dhe foto të mjetit

III.4.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta

mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.4.6. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.4.7. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.4.8. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.4.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.4.11. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, një ndër arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit është “*Mjeti targë AA 402 GY nuk është sipas kërkesave të DST është nën 1 ton [...]*”. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë 2 (dy) kamionçiona me kapacitet mbi 1 ton.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetet kamionçina, që është dhe një ndër arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. për këtë kriter ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve, ku deklarojnë se në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkim, disponojnë dy kamionçina, konkretisht kamionçininë me targë AA935RT, në emër të shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k. dhe kamionçininë me targë AA402GY në emër të shoqërisë “Drini – 1” sh.p.k. Referuar arsyes së skualifikimit, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, konkretisht, për mjetin me targë AA402GY, i paraqitur nga ky i fundit në përmbushje të kriterit për mjetin kamionçinë, referuar lejes së qarkullimit, rezulton se, ky mjet ka një kapacitet më të ulët se 1 ton, sic kërkohet në dokumentat e tenderit. Si rrjedhim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që duhet të paraqitet dokumentacion për mjetet kamionçin me kapacitet mbi 1 ton, konstatojmë se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla, me kapacitet mbi 1 ton, duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetin kamioncinë.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Rroku Guest” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74140-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë - Velipojë, U.Bunës (E re)-Shirokë, Krye Bushat-B.Jugë, Rranxa-Kukël, K.Balldre-Porta e Aviacionit 71.4 km*”, me fond limit 55.559.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
2. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALB-Konstruksion” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1439 Protokolli
Datë 27.08.2018

Nr. 1443 Protokolli
Datë 28.08.2018

Nr. 1447 Protokolli
Datë 29.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha